



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2023:292702

Datë: 11.04.2024

Numri i dokumentit: 05561480

C.nr.1167/2023

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA NË KAMENICË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, përmes gjyqtarit Artan Abazi, me bashkëpunëtoren profesionale Shkurte Kadriu, në çështjen juridike kontestimore të paditëses M. S. nga, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Enver Ajvazi, avokat nga Kamenica, kundër të paditurës Komuna e Kamenicës - Drejtoria e Arsimit, me objekt kontesti kompensimin e shujtës ditore, shpenzimet e udhëtimit, të inflacionit dhe licencimit, me vlerë të kontestit 2,868.60 euro, jashtë seancës, me datë 11.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar në ligj kërkesëpadia e paditëses M. S. nga, dhe Detyrohet e paditura Komuna e Kamenicës, që paditëses në emër të emër të kompensimit të diferencës së pagës për kualifikim shkollor, në lartësi 10 % të pagës bazë për periudhën prej 11 muaj të vitit 2021 dhe 11 muaj të vitit 2022 gjithsej për 22 muaj, shumën nga 27.40 € për çdo muaj e në shumë prej 657.60 euro, në emër të kompenzimit të shpenzimeve për ushqim (shujtës ditore), për 432 ditë pune, edhe atë për periudhën kohore prej 2021 deri në vitin 2022, t'ia paguaj shumën prej 864.00 euro, në kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit në lartësi 70 % të vlerës së biletës së trafikut urban, për 432 ditë pune, në shumë prej 604.80 euro, ndërsa në bazë të inflacionit për vitin 2021, shumën prej 156.60 euro dhe për vitin 2022 shumën prej 585.60 euro, e në shumë prej 742.20 euro, e gjithsej në shumë të përgjithshme prej **2,868.60 euro**, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e ushtrimit të padisë 20.12.2023, në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

II. DETYROHET e paditura, që paditëses t'ia paguajë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 144.00 euro, në afat prej 7 ditëve, pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

A r s y e t i m i

Paditësja, përmes të autorizuarit të saj, më datë 20.12.2023, në këtë gjykatë, ka paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Kamenicës-Drejtoria e Arsimit, me objekt kontesti kompensimin e shujtës ditore dhe shpenzimet e udhëtimit, me vlerë të kontestit prej 2,868.600 euro. Në padi ka theksuar se paditësja është në marrëdhënie pune të paditura pranë Shkollës së Mesme të Lartë “Desanka Maksimoviq”, në Kamenicë, në pozitën e arsimtares. Baza ligjore lidhur me këtë kërkesë ka theksuar se gjendet në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të dt.18.04.2017 dhe KKAK-së të dt.22.01.2021, në nenin 35 parag.5, 7 dhe 10.

Përfaqësuesi i paditëses, ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet në tërësi kërkesëpadija e paditëses, dhe të detyrohet e paditura që paditëses në emër të kompensimit të diferencës së pagës për kualifikim shkollor, në lartësi 10 % të pagës bazë për periudhën prej 11 muaj të vitit 2021 dhe 11 muaj të vitit 2022 gjithsej për 22 muaj, shumën nga 27.40 € për çdo muaj e në shumë prej 657.60 euro, në emër të kompenzimit të shpenzimeve për ushqim (shujtës ditore), për 432 ditë pune, edhe atë për periudhën kohore prej 2021 deri në vitin 2022, t’ia paguaj shumën prej 864.00 euro, në kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit në lartësi 70 % të vlerës së biletës së trafikut urban, për 432 ditë pune, në shumë prej 604.80 euro, ndërsa në bazë të inflacionit për vitin 2021, shumën prej 156.60 euro dhe për vitin 2022 shumën prej 585.60 euro, e në shumë prej 742.20 euro, e gjithsej në shumë të përgjithshme prej **2,868.60 euro**, këto me kamat ligjore prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, nën kërcënimin e përmbarimit ligjor. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar edhe atë 104.00 euro për përpilimin e padisë si dhe shumën prej 40.00 euro për taksën gjyqësore.

Gjykata konform nenit 394, 395 dhe 396 të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore (në vijim: LPK-së) të paditurës i ka dërguar aktvendimin për përgjigje në padi, së bashku me padinë dhe provat e bashkëngjitura padisë për tu deklaruar me shkrim në padinë e paditëseve.

E paditura, me anë të përgjigjes në padi, e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëseve pasi që kontratën të cilën e bazon paditësi nuk prodhon efekte juridike dhe nuk krijon të drejta dhe detyrime ndaj Komunës së Kamenicës, si e paditur, meqë e njëjta nuk është e regjistruar në MPMS-ës, si dhe është paraparë së bashkërisht MASHT-i dhe SBASHKU dhe Ministria e Financave angazhohen bashkërisht që të bëjnë sigurimin e mjeteve. Për më tepër ka theksuar se e paditura nuk ka marrë obligim përmbushjen e obligimeve që rrjedhin nga kontrata e lartëcekur e nga këto nuk ka legjitimitet real pasiv.

Gjykata, pas pranimit të përgjigjes në padi, ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së) për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, pasi që nga përgjigja në padi rezulton qartas se padia e paditëses është pjesërisht e bazuar.

Gjykata, para se të vendos në mënyrë meritorë në këtë çështje kontestimore i ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 398 i LPK-së, me të cilin përcaktohet se “kur gjykata, pasi t’i arrijë

përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”, dhe ka konstatuar se ekzistojnë kushtet ligjore për marrjen e këtij Aktgjykimi, pasi që faktet vendimtare nuk janë kontestuar nga ana e të paditurës, respektivisht nuk është kontestuar gjendja faktike, se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura.

Andaj, gjykata në këtë çështje kontestimore sa i përket të drejtës subjektive të paditëses dhe lartësisë së saj, ka zbatuar dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 18.04.2017 dhe KKAK-së të datës 22.01.2021, konkretisht nenin 35 parag.5 të kësaj kontrate, si dhe Mendimit juridik me nr.prot.214/2023, të datës 09.10.2023, të Gjykatës Supreme të Kosovës, ndërsa procedura është zhvilluar në bazë të Ligjit të Procedurës Kontestimore në fuqi.

Gjykata me rastin aprovimit të kërkesëpadisë, pati parasyshë dispozitën ligjore të nenit 35, parag. 5 të Kontratave Kolektive të Arsimit, ku është përcaktuar se *“Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë u paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban”,* andaj, në rastin konkret e obligoj të paditurën që paditëses t’ia kompensoj për 474 ditë pune, shumën prej 660.60 euro.

Ndërsa kërkesa e paditëses për shpërblimin në bazë të inflacionit, bazën ligjore e ka në nenin 35 paragrafi 10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë /Kontrata e datës 18.04.2017, ngase në nenin përkatës është përcaktuar se: *“ Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë.”,* e në rastin konkret gjykata e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses në të dhënat se shkalla mesatare vjetore e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, periudhën për vitin 2021, mesataren vjetore prej 3.10%, të inflacionit, për vitin (janar – nëntor) 2022, mesataren vjetore prej 11.6% të inflacionit, sipas pagës bazë në shumë prej 274.00 euro.

Në Vendimin e Qeverisë, Nr.01/33 të datës 29.08.2008, i cili vendim ka qenë në fuqi deri më datë 06.02.2023 (i shfuqizuar me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik, Nr.08/L-196), është përcaktuar se të gjithë mësimdhënësit do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit, pra mësimdhënësve, drejtorëve, zëvendësdrejtorëve dhe bashkëpunorëve profesional, përfitojnë rritje page me diplomë të shkollës normale 10 % të pagës bazë, me diplomë të shkollës pedagogjike me nje ngritje te pagës bazë prej 19%, me diplome universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35 %, në nenin 35 paragrafi 7 të kësaj Kontrate, ku theksohet se *“Të punësuarve, u sigurohen kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë për një ditë pune është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arismore. Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restorantit a kuzhinës ose në një formë tjetër nuk ka obligim kompensimin për ushqim”,* në rastin konkret institucionet shkollore nuk e kanë të rregulluar ushqimin përmes restoranteve apo kuzhinave, andaj e obligoj të paditurën që paditësit për

kompensimin e shujtës ditore për 432 ditë pune t'ia paguaj shumën prej nga 864 euro. Gjykata sa i përketë ditëve të pranisë në punë për paditësen është bazuar në vërtetimin nr.86/23 të dt.10.10.2023, të leshuar nga Shkolla e Mesme të Lartë "Desanka Maksimoviq", në Kamenicë

Ndërsa sa i përketë shpenzimeve të udhëtimit për paditësin për 432 ditë punë, në lartësi 70% të biletës së udhëtimit, shumën prej 604.80 euro (*shumë kjo e kërkuar nga pala paditëse*), gjykata mori parasyshë dispozitën e nenit 35 parag.5 të KKAK, ngase paditësja jeton ne Ranillug (fakt i bazuar nga Certifikata e vendbanimit, në emër të paditësit), ndërsa sa i përketë lartësisë së kompensimit gjykata pati parasyshë çmimin i biletës së udhëtimit për dy drejtime nga fshati Ranillug për në Kamenicë, është 1.00 euro, për dy drejtime.

Pretendimet e përfaqësuesit të palës së paditur se Kontrata Kolekive e Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 dhe KKAK e dt.22.01.2021, nuk është e regjistruar, si dhe faktin se të njëjtit nuk janë palë nënshkruese të kësaj Kontrate Kolektive të Arsimit dhe për të njëjtit si Drejtori Komunale e Arsimit, nuk paraqet ndonjë detyrim, duke konsideruar se nuk kanë legjitimitet real pasiv në këtë çështje juridike kontestimore dhe e njëjta të refuzohet si e tillë, për faktin se paditësja nuk ka arritur ta vërtetojë kërkesëpadinë e tij, për gjykatën këto pretendime ishin të pa bazuara, për faktin se me nenin 2, të Kontratës Kolektive të lartëcekur, të gjitha Drejtoritë Komunale të Arsimit, në Kosovë, janë të obliguara ta zbatojnë Kontratën Kolektive të lartëcekur dhe me kohë të planifikojnë mjete buxhetore për këto raste, poashtu duke u bazuar në nenin 6, paragrafi 4, pika 2, të kësaj kontrate Kolektive të lartëcekur, paditësi, me pozitë të punës mësimdhënës lëndor, hynë në kuadër të përfituesve të të drejtave që rrjedhin nga kjo Kontratë Kolektive e Arsimit. Andaj, përgjegjësia për kompensim e shpenzimeve te udhëtimit dhe inflacionit është te e paditura, respektivisht të DKA-së, në Kamenicë.

Gjykata për kamatën ligjore prej 8% ka vendosur duke u bazuar në dispozitën e nenit 382 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Gjykata duke patur parasysh suksesin në procedurë të paditësit dhe duke u bazuar në nenin 449, 452 dhe 463, parag. 1 të LPK-së dhe nr. tarifor 6 dhe 7 të Rregullores për Tarifat e Avokatëve, të datës 18.03.2017, ka aprovuar pjesërisht kërkesën për shpenzimet e kërkuara nga i autorizuari i paditësit, ashtu që e ka detyruar të paditurën që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës, edhe atë: për përpilimin e padisë, shumën prej 104.00 euro, dhe për taksë gjyqësore, shumën prej 40.00 euro, e në shumën e përgjithshme prej 144.00 euro.

Gjykata, nga të lartëcekurat e bazuar në nenin 143, paragrafi 1 lidhur me nenin 398 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA NË KAMENICË

Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil

C.nr.1167/2023, të datës 11.04.2024

**Gjyqtari,
Artan Abazi**

Udhëzim Juridik: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimi të të njëjtit. Ankesa dorëzohet në dy ekzemplar përmes kësaj gjykate.